



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1610/11 prot

Datë 01.11.2021

V E N D I M

K.P.P. 826/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.11.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*,” me Nr. REF-00413-07-07-2021, me objekt “*Ndërtim i godinës së re për akomodimin e QSH Nr.1, NJVKSH dhe Klinikës Stomatologjike Durrës*”, me fond limit 72,496,412 (shtatëdhjetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.07.2021, nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK
Rruga “Adem Jashari”, Nd. 4, H., 10, Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës
Lagjja Nr. 4, Rr.”Fetah Billaca”, Durrës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” , Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 08.07.2021, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-00413-07-07-2021, me objekt “Ndërtim i godinës së re për akomodimin e QSH Nr.1, NJVKSH dhe Klinikës Stomatologjike Durrës”, me fond limit 72,496,412 (shtatëdhjetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e

dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.07.2021, nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës.

II.2. Në datën 30.07.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 17.08.2021, ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përkatësisht:

“Elda-VI” SHPK	0 lekë	skualifikuar
“Eurovia shpknj”	46,294,313.21 lekë	skualifikuar
“Braka Construction” SHPK	48,435,877.20 lekë	skualifikuar
“Nika” SHPK	49,561,426.70 lekë	skualifikuar
“Bajrami N” SHPK	50,602,239.60 lekë	skualifikuar
“Kevin Konstruksion” SHPK	58,026,329.60 lekë	skualifikuar
“Blerimi” SHPK	60,845,269.31 lekë	skualifikuar
“Colombo” SHPK	61,990,828.80 lekë	kualifikuar
“Pe-vla-ku” SHPK	62,709,395.70 lekë	skualifikuar
“Be-Is” SHPK	66,832,386.40 lekë	skualifikuar
“Franko Construction” SHPK	71,030,032 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 17.08.2021 operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, sipas argumentimi/arsyetimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, si më poshtë vijon:

a. Nuk ka paraqitur vërtetim OSHEE.

Nuk ka paraqitur vërtetim për pagesë detyrimesh.

b. Një pjesë e konsiderueshme e punonjësve të paraqitur profesionistë nuk janë të përfshirë në listëpagesën e paraqitur nga OE Drejtuesit e mjeteve pa kontratë pune jo pjesë e listëpagesës Karpentierët disa pa kontrata pune disa nuk janë pjesë e listëpagesës.

c. Autoboti i ujit nga fotoja dallohet që ka shenjën e flakës që do të thotë që është mjet për transport të lëndëve të rrezikshme.

Autoboti tjetër i paraqitur ka dokumente të skaduara.

Automjete vetëshkarkuese +18T disponon vetëm 2 nga 3 të kërkuara në DST.

II.5. Në datën 23.08.2021 është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 130, me datë 30.08.2021.

II.6. Nga verifikimet e kryera, konstatohet se në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 130, me datë 30.08.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar njoftimi i fituesit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku rezulton fitues operatori ekonomik “Colombo” SHPK.

II.7. Në datën 30.08.2021, operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1610/2 prot., datë 31.08.2021 lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.9. Me shkresën me nr. 574/1 prot., datë 07.09.2021 protokolluar me tonën respektivisht me nr. 1610/3 prot., datë 08.09.2021, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK dhe me shkresën nr. 574/1 prot., datë 07.09.2021, e ka njoftuar atë, se ka vendosur **mos pranimin të ankesës**.

II.11. Operatorit ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK, formularin e ankesës nr. 147 prot., me datë 09.09.2021 protokolluar me tonën respektivisht me nr. 1610/4 prot., datë 13.09.2021, ka dorëzuar përsëri formular ankese pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.12. Me shkresën nr. 1610/5 prot., datë 27.09.2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka dërguar shkresë me lëndë “*Kërkesë për informacion*”, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, në lidhje me zgjatjen e afateve të vlefshmërisë së certifikatës së kontrollit teknik për kategori mjetesh të ndryshme.

II.13. Me shkresën nr. 20137/1 Prot., datë 07.10.2021, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 1610/7 prot., datë 11.10.2021, Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve e Transportit Rrugor ka dërguar shkresën me lëndë “*Kthim-përgjigje*”.

II.14. Me shkresën nr. 1610/8 prot., datë 13.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka dërguar shkresë me lëndë “*Rikërkesë për informacion*”, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, në lidhje me zgjatjen e afateve të vlefshmërisë së certifikatës së kontrollit teknik për kategorinë e mjeteve autobot uji.

II.15. Me shkresën nr. 574/2 prot, datë 18.10.2021, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 1610/9 prot., datë 19.10.2021, i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar përsheptim vendimi përfundimtar.

II.16. Me shkresën nr. 20137/3 Prot., datë 26.10.2021, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 1610/10 prot., datë 27.10.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve e Transportit Rrugor ka dërguar shkresën me lëndë “Kthim-përgjigje”.

II.17. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së vet, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen : “[...] Në lidhje me pretendimin se “Autoboti i ujit nga fotoja dallohet që ka shenjën e flakës që do të thotë që është mjet për transport të lëndëve të rrezikshme, dhe autoboti tjetër i paraqitur ka dokumente të skaduara: sqarojmë: Në kriteret kualifikuese autoriteti kontraktor ka kërkuar: “Autobot ujë 1 copë” të vërtetuar me “Për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjet e mësipërme duhet:

Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentet si: Leja e qarkullimit, Certifikata e Kontrollit Teknik, Police sigurimi, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në regjistra publike duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/te dhëna teknike, ose ekuivalenti i tij/saj). Në përmbushje të këtij kriteri kualifikues operatori ynë ekonomik ka paraqitur:

1.Kontratë qiraje me qiramarrësin ”Kevin konstruksion” SHPK dhe qiradhënësit ”Mela SHPK për mjetin autobot uji me targë TR 9983 R me afat për të gjithë kohën e nevojshme që kërkohet për të përfunduar të gjitha punimet të parashikuar për tu kryer në këtë objekt prokurimi. Shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a-certifikatë pronësie mjeti me targë TR9983R.

b-leje qarkullimi i mjetit me targë TR9983R.

c-certifikatë kontrolli teknik i mjetit me targë TR9983R.

d-taksa vjetore të mjetit me targë TR9983R të paguara në datë 14.12.2020.

e-police sigurimi i mjetit me tragë TR9983R të paguara deri në datë 20.11.2021.

f-certifikatë transport mallrash i mjetit me targë TR9983R.

Pretendimi i autoritetit kontraktor se ky mjet ka shenjën e flakës në foto çka e bënë atë automjet për transport lëndësh të rrezikshme është absurd. Së pari në foto nuk dallohet asgjëkund shenjë flake së dyti përcaktimin e llojit të mjetit e bëjnë institucionet shtetërore nëpërmjet të dhënave që shënohen në certifikatën e pronësisë dhe lejen e qarkullimit të mjetit. Ku konkretisht ky mjet është cilësuar i llojit ATV dhe kodi i karrocërisë C3. Po të vihet re dhe mjete autobot uji tjetër i paraqitur në tender është me kod karrocërie C3. Gjithashtu mjete është i pajisur me certifikatë transport mallrash dhe jo me certifikatë transport mallrash të rrezikshme nëse do të ishim përpara rastit që një mjet për transport lëndësh të rrezikshme. Nuk është autoriteti kontraktor që përcakton llojin dhe tipin e kamionit por institucionet kompetente dhe në kushtet kur Bashkia Tiranë ka lëshuar certifikatë për transport mallrash nuk ngelet më vend për aludime të tilla të pabazuara. Gjithashtu, në lidhje me pretendimin tuaj se autoboti i ujit ka letrat e skaduara sqarojmë se në kriteret kualifikuese autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar në asnjë moment paraqitjen e police sigurimi të vlefshme por ka kërkuar vetëm paraqitjen e saj pjesë e marrëveshjes së marrjes së automjetit në posedim. Ndodhur në këto kushte jemi përpara një arsye skualifikimi mbi një kriter kualifikues të pakërkuar dhe si i tillë ai duhet rrëzuar. Për sa më sipër pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qëndron.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kapaciteti teknik”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

g.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji Makinerive	SASIA
<i>Automjet vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 3.5-7.5 ton</i>	<i>1 copë</i>
<i>Automjet vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 7.5-18 ton</i>	<i>3 copë</i>
<i>Automjete vetëshkarkuese me masë maksimale të autorizuar mbi 18 ton</i>	<i>3 copë</i>
<i>Fadromë</i>	<i>1 copë</i>
<i>Eskavator me goma</i>	<i>1 copë</i>
<i>Autobetonierë</i>	<i>1 copë</i>
Autobot Uji	1 copë

Skela	500 m ²
-------	--------------------

Për të vertetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjet e mësipërme duhet:

Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentet si:

-Leja e qarkullimit,

-Certifikata e Kontrollit Teknik,

-Police sigurimi,

-Foto e mjetit

(Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në regjistra publike duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/te dhëna teknike, ose ekuivalenti i tij/saj.)

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar:

-Formularin e përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8).

-për mjetin **Autobot Uji me targa TR9983R**, kontratë më datë 29.07.2021 qiradhënie midis palëve shoqëria “Mela” SHPK dhe shoqëria “Kevin konstruksion” SHPK, certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi lloji mjetit ATV dhe karrocera C3, certifikatë e kontrollit teknik të mjetit me afat deri me 03.02.2021, Police sigurimi me afat 21.11.2020-20.11.2021, certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet, foto.

-për mjetin **Autobot Uji me targa AA297LY**, kontratë qiraje me Nr. 1921 Kol., Nr. 401 Kol., datë 25.03.2020 (afat 5 vjeçar), midis palëve shtetasit Z. K. D., dhe shoqëria “Kevin konstruksion” SHPK, certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi lloji mjetit ATV dhe karrocera C3, certifikatë e kontrollit teknik të mjetit me afat deri me 16.06.2021, Police sigurimi me afat 11.06.2020-10.06.2021, foto.

III.1.3. Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar

kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.4. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[...]”

Në nenin 42 “Dispozita kalimtare”, të Ligjit nr. 63/2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8378, dt. 22.07.1998, Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar parashikon se: “Certifikatave të kontrollit teknik, që janë të vlefshme në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, iu zgjatet afati i vlefshmërisë sipas afateve të reja të parashikuara në të”.

Ligjit nr. 6/2021 “Për Miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e Ligjit, Nr. 36, Datë 23.12.2020 “Për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së certifikatës së Kontrollit Teknik”, është vendosur se: “Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 36, datë 23.12.2020, “Për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së certifikatës së kontrollit teknik”, miratuar në datë 28.01.2021.

Në nenin 1 të Aktit normativ Nr. 36, Datë 23.12.2020 “Për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së certifikatës së Kontrollit Teknik”, parashikohet se: “Zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së certifikatës së kontrollit teknik, të mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre, me një periudhë prej 3 (tre) muajsh”.

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.6. Sikundër pasqyruar më sipër për një shqyrtim sa më të drejtë dhe transparent të pretendimeve të palës ankimese, KPP gjykoi të nevojshme ti drejtohej Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve e Transportit Rrugor duke kërkuar informacion lidhur me ndryshimet respektive për afatin e vlefshmërisë së certifikatës së kontrollit teknik për mjetet.

Konkretisht, referuar kriterit në lidhje me dokumentacionin që duhet të paraqesin ofertuesit për mjetet e kërkuara, pikërisht për vlefshmërinë e certifikatës së kontrollit teknik dhe policës së sigurimit, dhe për shkak të ndryshimeve në Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përkatësisht ato me Ligjin nr. 63/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8378, dt. 22.07.1998, Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Ligjit nr. 6/2021 “Për Miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e Ligjit, Nr. 36, Datë 23.12.2020 “Për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së certifikatës së Kontrollit Teknik”, Komisionit të Prokurimit Publik, iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për marrjen e informacionit të nevojshëm lidhur me ndryshimet respektive për afatin e vlefshmërisë së certifikatës së kontrollit teknik për mjetet. Referuar interpretimit të dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve e Transportit Rrugor me shkresat me nr. 20137/1 Prot., datë 07.10.2021, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 1610/7 prot., datë 11.10.2021, dhe me shkresën me nr. 20137/3 Prot., datë 26.10.2021, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 1610/10 prot., datë 27.10.2021, na informon se “Referuar Aktit Normativ Nr. 36, datë 23.12.2020 “Për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së certifikatës së Kontrollit Teknik” miratuar me ligjin Nr. 6/2021 zgjatet 3 muaj vlefshmëria e certifikatave të kontrollit teknik (kolaudimit) të cilat ishin jashtë afatit të vlefshmërisë. Përpos kësaj shtyrje, u vlerësua e nevojshme dhe për një shtyrje të dytë në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 237, datë 31.03.2021 “Për lëshimin e kopjeve përmbledhëse të dokumenteve të qarkullimit ose drejtimit të mjetit”. Të gjitha këto mjete që ju mbaron afati i parashikuar në aktin normativ nr. 36, datë 23.12.2020, do të trajtohen të njehsuara sipas përcaktimit të nenit 91 për lëshimin e kopjes përmbledhëse, të dokumenteve të qarkullimit të parashikuar në nenin 178, të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar. Pra këto mjete do të pajisen me lejen e

qarkullimit ose certifikatën e kontrollit teknik, me vulë me afat vlefshmërie 30 ditë nga mbarimi i afatit të parashikuar në aktin normativ nr. 36, datë 23.12.2020. Taksat vjetore të mjeteve duhet të paguhen rregullisht në afatet ekzistuese, pranë drejtorive rajonale e nënzyrave të DPSHTRR ose përmes shërbimit e-albania online, pavarësisht nëse preken apo jo nga ndryshimet e shërbimit të kontrollit teknik. Më datë 31.05.2021 DPSHTRR njoftoi për rifillimin e shërbimit të kontrollit teknik të mjeteve rrugore, hapje graduale e këtij shërbimi sipas një kalendari të mirëorganizuar dhe kategorive më proiritare për transportin rrugor si më poshtë: -Kamionë, rimorkio dhe tërheqësit të cilëve iu ka skaduar certifikata e mëparshme e kontrollit teknik e lëshuar nga SGS. – Të gjithë mjetet rrugore në pronësi të institucioneve shtetërore.....Funksionimi normal i kontrollit teknik ka filluar më datë 01.06.2021 ku të gjithë drejtuesit e mjeteve kanë detyrimin ligjor dhe mundësinë që, duke filluar nga 01.06.2021, të kryejnë kontrollin teknik.....

1.Certifikata e kontrollit teknik për automjetet për transport të veçantë (ATV) Autobot Uji, ka pasur vlefshmëri 1 (një) vit.

2.Mjetet që ju ka skaduar vlefshmëria si dhe është tejkaluar shtyrja, ju është dhënë mundësia nga data 01.06.2021 të kryejnë kontrollin teknik”.

Pra, për sa më sipër, Komisioni sqaron se, me Aktin Normativ Nr. 36, datë 23.12.2020 “Për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së certifikatës së Kontrollit Teknik” miratuar me ligjin Nr. 6/2021 zgjatet 3 muaj vlefshmëria e certifikatave të kontrollit teknik (kolaudimit) të cilat ishin jashtë afatit të vlefshmërisë. Gjithashtu, me Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 237, datë 31.03.2021, këto mjete do të pajisen me lejen e qarkullimit ose certifikatën e kontrollit teknik, me vulë me afat vlefshmërie 30 ditë nga mbarimi i afatit të parashikuar në aktin normativ nr. 36, datë 23.12.2020. Por, Taksat vjetore të mjeteve duhet të paguhen rregullisht në afatet ekzistuese, pranë drejtorive rajonale e nënzyrave të DPSHTRR ose përmes shërbimit e-albania online, pavarësisht nëse preken apo jo nga ndryshimet e shërbimit të kontrollit teknik. Afatet e pagesave të taksave duhet të respektohen nëse është plotësuar afati prej 365 ditë nga pagesa e vjetshme.

Referuar kriterit të kualifikimit në lidhje me mjetet e kërkuara, autoriteti kontraktor ka kërkuar ndër të tjera, që ofertuesi duhet të disponojë një mjet Autobot Uji me dokumentacionin shoqërues. Për plotësimin e këtij kriteri, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), dy mjete Autobot Uji me targa respektive TR9983R dhe AA297LY me dokumentacionin shoqërues. Në lidhje me pretendimin e ankimuesit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), konkretisht për mjetin Autobot Uji, Komisioni konstaton se, për mjetin Autobot Uji me targë TR9983R me certifikatë e kontrollit teknik të mjetit me afat deri me 03.02.2021, Police sigurimi me afat 21.11.2020-20.11.2021, duke marrë në konsideratë shtyrjet e afateve të parashikuara në dispozitat ligjore të sipërcituara, ky mjet nuk e plotëson kriterin në lidhje me vlefshmërinë e certifikatës së kontrollit teknik të mjetit. Ndërsa, polica e sigurimit është brenda afateve, duke marrë në konsideratë që procedura e prokurimit objekt ankimi është zhvilluar më datë

30.07.2021. Për mjetin Autobot Uji, Komisioni konstaton se, për mjetin Autobot Uji me targë AA297LY me certifikatë e kontrollit teknik të mjetit me afat deri me 16.06.2021, Police sigurimi me afat 11.06.2020-10.06.2021, duke marrë në konsideratë shtyrjet e afateve të parashikuara në dispozitat ligjore të sipërcituara, ky mjet e plotëson kriterin në lidhje me vlefshmërinë e certifikatës së kontrollit teknik të mjetit. Ndërsa, polica e sigurimit është jashtë afateve (e skaduar), duke marrë në konsideratë që procedura e prokurimit objekt ankimi është zhvilluar më datë 30.07.2021. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” SHPK për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, pasi operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të KPP do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-00413-07-07-2021, me objekt “Ndërtim i godinës së re për akomodimin e QSH Nr.1, NJVKSH dhe Klinikës Stomatologjike Durrës”, me fond limit 72,496,412 (shtatëdhjetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.07.2021, nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” ShPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Anila Malaj	Kreshnik Ternova
	Kryetar	
	Jonaid Myzyri	